



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samoupraveć
Ministry of Local Government Administration

Datë: 24.04.2013
Nr. 0203-462

PËR: Smajl Latifi, Kryetar i Komunës së Rahovecit
Xhemajl Haxhimustafa, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Rahovecit

LËNDA: KONFIRMIM I LIGJSHMËRISË SË VENDIMIT TË KOMUNËS SË RAHOVECIT, 01Nr.8/2013, Pranuar me datë, 10.04.2013.

Të nderuar/a

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, në përputhje me mandatin e saj të përcaktuar me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, shtojcën XII të Rregullores Qeveritare 02/2011 për Fushat dhe përgjegjësitë administrative të Zyrës së Kryeministrit Ministrive, pas shqyrtimit të Vendimit 01Nr.8/2013, të miratuar me datë 02.04.2013, **KONFIRMON** ligjshmërinë e këtij akti dhe vlerëson se i njëjti është në harmoni me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale.

Akti juridik i listuar si në vijim, ka efekt të plotë juridik.

- Vendimi 01Nr.8/2013, për Aprovimin e kërkesës së qytetarëve të Lagjes "Krajisht" të cilët i përfaqëson Hysen Mahmut Hamza nga Rahoveci për konsituimin e të drejtës së servitutit sendor në pronësi komunale.

Me respekt,

Slobodan Petrović,
Zëvendëskryeministër dhe Ministër i MAPL-së,

Kopje: Besnik Osmani, Sekretar i Përgjithshëm i MAPL-së
Udhëheqësve të Departamenteve të MAPL-së
Arkivit të MAPL-së.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samoupraveć
Ministry of Local Government Administration

Datum: 24.04.2013
br. 0203-462

Za: Smajl Latifi, Gradonačelnik opštine Orahovac
Xhemajl Haxhimustafa, Predsedavajući Skuopštine opštine Orahovac

Predmet: Potvrda zakonitosti odluke opštine Orahovac, 01br.8/2013, primljeno dana ,
10.04.2013.

Poštovani/e

Ministarstvo administracije lokalne samouprave u skladu sa njenim mandatom, definisano zakonom o lokalnoj samoupravi br. 03/z-04, dodatak XII uredbe Vlade 02/2011 o odgovornim administativnim oblastima kancelarije Premijera i Ministarstva nakon razmatranja odluke 01br.8/2013, odobreno dana 02.04.2013, **POTVRĐUJE** zakonitost ovog akta i procenjuje da je isti taj u potpunom skladu sa zakonom o lokalnoj samoupravi .

Pravni akt sa potpunim pravnim dejstvom je , kao što sledi,

Odluka 01br.8/2013, o usvajanju zahteva građana naselja "Krajisht" koje zastuplja Hysen Mahmut Hamza iz Orahovca za uspostavljanje prava službenosti u vlasništvu opštine.

Sa poštovanjem,

Slobodan Petrović,
Zamenik premijera i Ministar MALS-a,

Kopije: Besnik Osmani, Generalni sekretar MALS-a
Rukovodiocima odeljenja MALS-a
Arhivi MALS-a.



Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Kuvendi Komunal Rahovec/Skupština Opštine Orahovac/Municipal Assembly Rahovec



Kuvendi i Komunës së Rahovecit, duke vendosur sipas kërkesës së grupit të qytetarëve të Lagjes "Krajisht", të cilët i përfaqëson Hysn Mahmut Hamza, nga Rahoveci, në çështjen administrative-konstituimi i të drejtës së servitutit në pronësinë komunale, në bazë të nenit 17, 43 dhe 52 të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale nr. 03/L-040, nenit 253 të Ligjit për pronësinë dhe të drejtat tjera sendore nr. 03/L-154, nenit 13 dhe 84 të Ligjit mbi procedurën administrative nr. 02/L-28 dhe nenit 5 dhe 36 të Statutit të Komunës së Rahovecit, merr

V E N D I M

Neni 1

Aprovohet kërkesa e qytetarëve të Lagjes "Krajisht" të cilët i përfaqëson Hysen Mahmut Hamza, nga Rahoveci, për konstituimin e të drejtës së servitutit sendor në pronësinë komunale – ngastra nr. 2680-2, në vendin e quajtur "Krajisht", sipas kulturës kullosë (djerrinë) në drejtim lindje – perëndim, në gjatësi prej 37 metra dhe gjerësi prej 4 metra, në sipërfaqe të përgjithshme prej 148 m², nga certifikata mbi të drejtat e pronës së paluajtshme nr. 613 z.k. Rahovec, P.Sh. e Kosovës, titullar Komuna e Rahovecit.

Neni 2


Krijimi i të drejtës së kalimit në ngastrën komunale nr. 2680-2 dedikohet vetëm për nevojat e banorëve të Lagjes "Krajisht" të cilët posedojnë shtëpitë banesore por nuk kanë qasje në rrugën publike dhe si bartësit e të drejtës së kalimit, në bazë të këtij vendimi, do të kenë mbrojtjen e të drejtës së autorizuar dhe në kohë të pacaktuar të shfrytëzojnë rrugën si e mirë publike, e cila rrjedh nga e drejta e pronësisë në paluajtshmërinë shërbyese të tokës komunale, me kusht që ndërtimin dhe meremetimin e rrugës të kryejnë me shpenzimet e veta.

Neni 3

Obligohet Drejtoria për Kadastër, gjeodezi dhe pronë që nëpërmjet ekspertit të gjeodezisë në vendin e ngjarjes të kryej incizimin dhe matjen e ngastrës komunale nr. 2680-2, ndërsa Zyra kadastrale komunale, sipas detyrës zyrtare do të kryej regjistrimin e pronës komunale për ndërrim destinomi prej kullose në rrugë publike.

Neni 4

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për kadastër, gjeodezi dhe pronë e KK Rahovec.



Neni 5

Ky vendim hyn në fuqi 8 ditë nga dita e marrjes së tij.

01 Nr. 8/2013
Rahovec, 02.04.2013

Kuvendi i Komunës së Rahovecit



Kryesnesi i Kuvendit

Xhemali Haxhimustafa